



Organizata jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDARYSHE

8 qershor 2018, Prizren

KOMUNIKATË

Prizreni, "qytet muze" pa muze

EC Ma Ndryshe ka publikuar hulumtimin "Prizreni, 'qytet muze' pa muze", në kuadër të së cilit është pasqyruar gjendja ekzistuese e gjithsej gjashtë muzeve të qytetit të Prizrenit dhe janë adresuar çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e tyre. Duke qenë se shumica e muzeve në Prizren janë ose të mbyllur ose të panjohur për publikun e gjerë, atëherë EC ka marrë si iniciative këtë hulumtim me qëllim të prezantimit të gjendjes momentale dhe sjelljes së rekomandimeve konkrete për ringjalljen dhe promovimin e këtyre institucioneve kulturore. Në këtë hulumtim janë analizuar poashtu edhe praktikat muzeve të tjerë në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar në mënyrë që të sillen shembuj të tjerë që mund të shërbejnë si praktika pozitive të cilat mund të aplikohen nga muzetë e qytetit të Prizrenit.

Qyteti i Prizrenit, krahas epitetit të kryeqytetit kulturor të Kosovës, sipas perceptimit të përgjithshëm të publikut kosovar është qytet me vlera të lashta kulturore dhe historike dhe mban edhe epitetin e "Qytetit muze". Ky epitet domosdoshmërisht reflekton ruajtjen e strukturës së saj historike dhe rrjedhimisht nënkupton edhe promovimin e kësaj pasurie tek publiku i gjerë. Një nga mjetet e promovimit të kësaj pasurie të Prizrenit janë edhe muzetë që mes tjerash kanë po këtë mision. Mirëpo a e meriton një epitet të tillë sot Prizreni? Sa muze sot gjenden në Prizren dhe sa prej tyre janë funksionale e të hapura për publik? Në çfarë gjendje janë dhe çfarë ofrojnë muzetë e këtij qyteti? Sa reflektohet diversiteti kulturor i këtij qyteti në muzetë e saj?

Hulumtimi ka analizuar aspekte të ndryshme të funksionimit të gjashtë muzeve të qytetit dhe ka karahasuar përmbajtjen e tyre me standarde bashkëkohore të muzeve në rajon e botë. Muzetë e përfshirë në hulumtim janë: 1. Muzeu i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 2. Muzeu arkeologjik - Hamami i Shemsidin beut dhe Sahatkulla, 3. Muzeu etnologjik - Shtëpia e shehzades, 4. Muzeu i hapur arkeologjik si dhe dy muze tjera 5. Muzeu i elektroekonomisë – Hidroelektrana "Prizrenasja" 6. Muzeu i Nënë Terezës të cilat nuk janë funksion dhe të hapura për publik.

Bazuar në të dhënat e prezantuara në këtë hulumtim del të jetë se në Prizren dy muze janë tërësisht të mbyllur për publikun; muzetë e tjerë nuk i plotësojnë në tërësi standardet ndërkombëtare të aplikueshme; prezantimi dhe mirëmbajtja e fondit të vlefshëm brenda tyre nuk bëhet në mënyrë adekuate; si dhe ka mungesë të theksueshme të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale në shërbim të këtyre muzeve. Rrjedhimisht del se epiteti "Qytet muze" përfshirë këtu humbjen dhe degradimin e

viteve të fundit në lokalitetet e trashëgimisë kulturore, duket të jetë i pamërituar për qytetin e Prizrenit. Hulumtimi përmbillet me konkluzione dhe rekomandime që i adresohen Ministrisë së Kulturës, Komunës së Prizrenit dhe menaxhmentit të muzeve të qytetit. Këtu mund ta gjeni hulumimin e plotë: <https://bit.ly/2sDĚdNQ>

Ky hulumtim është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771